

Ndikimi i kogjenerimit
në konsum të
energjisë





SHKURTESAT

- ASK** → Agjencia e Statistikave të Kosovës
- BB** → Banka Botërore
- BE** → Bashkimi Evropian
- KE** → Komisioni Evropian
- KEDS** → Kompania e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në Kosovë
- ktoe** → Kilo ton oil ekuivalent
- KfW** → Banka Gjermane për Zhvillim
- MWth** → Mega Vat Energji Termike
- NQ** → Ngrohje Qendrore
- TE** → Traktati i Energjisë
- ZRrE** → Zyra e Rregullatorit të Energjisë

Përmbledhje ekzekutive

Qeveria e Kosovës dhe Komuna e Prishtinës, me ndihmën e donatorëve ndërkombëtarë, në fund të vitit 2014 arritën ta funksionalizojnë projektin e kogjenerimit – apo lidhjen e termocentralit “Kosova B” me ngrohtoren e qytetit të Prishtinës Termokos.

Ky investim prej 37 milionë eurosh shumë shpejt dha rezultate pozitive dhe është një ndër investimet më të suksesshme kapitale në vitet e fundit.

Termokos-i ka një rrjet prej afro 12 mijë konsumatorëve. Për shumë vite, ngrohtorja e qytetit nuk ishte funksionale, për shkak të problemeve të mëdha në menaxhim, furnizim me mazut, rrjetit të dëmtuar dhe mos pagesës së faturave nga konsumatorët. Përdorimi i avullit të termocentralit “Kosova B” për të ngroh hapësirat banuese të konsumatorëve të Termokos-it, bëri që shumë probleme të kësaj ndërmarrje të zgjidheshin përnjëherë.

Instituti GAP ka analizuar ndikimin e kogjenerimit në konsumin e energjisë elektrike në Prishtinë. Për këtë qëllim, GAP ka zhvilluar 350 anketa me konsumatorë të Termokos-it, ku janë krahasuar dy sezonet e fundit dimërore: periudha para kogjenerimit (dhjetor 2013 - janar 2014), dhe periudha pas kogjenerimit (dhjetor 2014 - janar 2015). Të gjeturat e studimit tregojnë se konsumi i energjisë elektrike ka rënë për 34%, arkëtimi është rritur për 176%, kurse pakënaqësia e konsumatorëve ndaj cilësisë së ngrohjes brenda një viti ka rënë nga 94% në 8%.

Duke parë këto të dhëna inkurajuese sa i përket uljes së konsumit të energjisë elektrike, Instituti GAP rekomandon investime më të mëdha në zgjerimin e rrjetit të Termokos-it, funksionalizimin e ngrohtoreve ekzistuese në qytetet tjera të Kosovës dhe gjetjen e mundësive për ndërtimin e ngrohtoreve të reja.

Investime të tilla, përveç që do të ndikonin direkt në ngritjen e kualitetit të jetës së qytetarëve, ato do të ndikonin edhe në zvogëlimin e kërkesës për energji elektrike.

1. Hyrje

Një ndër problemet madhore që nga pas lufta është edhe furnizimi jo i rregullt me energji elektrike, si në sektorin e amvisërisë, ashtu edhe në atë industrial. Problemet me energjinë elektrike e kanë burimin tek prodhimi jo i mjaftueshëm i energjisë, por edhe tek eficientia e ulët e shfrytëzimit të saj nga ana e konsumatorëve final.

Sipas të dhënave të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), më 2014, nga 402.09 ktoe energji e konsumuar, 58% është konsumuar nga sektori i amvisërisë, kurse pjesa tjetër nga sektori i industrisë (27%) dhe shërbimet (15%)¹.

Në mungesë të një sistemi adekuat të ngrohjeve publike, një pjesë e madhe e energjisë elektrike shfrytëzohet për ngrohjen e hapësirave të banimit dhe të punës. Përdorimi i energjisë elektrike për ngrohje gjatë sezonit të dimrit, bën që konsumi i energjisë elektrike në muajt më të ftohtë të dimrit të dyfishohet në krahasim me muajt e verës. Po ashtu, së bashku me tarifat dimërore të energjisë, energjia e përdorur për ngrohje ndikon edhe në ngritjen e çmimit të faturave të energjisë elektrike.

Prishtina është qyteti me konsumin më të lartë të energjisë elektrike në vend². Për shkak edhe të izolimeve të dobëta të objekteve banuese, pjesa më e madhe e këtij konsumi përdoret për ngrohje. Mundësitë alternative të ngrohjes si druri, qymyri dhe gazi natyror janë më të vogla në Prishtinë sesa në qytetet tjera. Si rezultat, pavarësisht çmimit të lartë, energjia elektrike është bazë për ngrohjen e hapësirave të banimit dhe të punës.

Një mënyrë për të ulur konsumin e përgjithshëm të energjisë elektrike për ngrohje në zonat urbane, është përdorimi i sistemit të ngrohjes qendrore, i cili mundëson që përmes prodhimit në masë të madhe, të ofrojë ngrohje cilësore dhe me kosto më të përballueshme.

Mirëpo, në Prishtinë Termokos-i mbulon vetëm 5% të kërkesës, apo 12,000 konsumatorë me rreth 1.1 milion m².³ Viteve të fundit, problemet e furnizimit me ngrohje kanë qenë mjaft serioze, ngase kjo kompani operonte me mazut, çmimi i të cilit rritej vazhdimisht dhe ia

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Balanca vjetore e energjisë në Republikën e Kosovës 2014. Fq.11.

² Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRë) - Raporti vjetor 2014. Fq. 47. Burimi: <http://bit.ly/1CUGICA> (hapur së fundi më 22 korrik 2015)

³ Kompania e ngrohjes qendrore "Termokos"- Informata Rreth Projektit Të Kogjenerimit. Burimi: <http://bit.ly/1HQMKE> (hapur së fundi më 22 korrik 2015).

pamundësonte Termokos-it që të ofrojë ngrohje gjatë gjithë sezonit dimëror⁴. Për të përmbushur nevojën për ngrohje, konsumatorët e Termokos-it përdornin energjinë elektrike, duke e rritur kështu edhe më shumë kërkesën e përgjithshme për energji.

Po ashtu, rrjeti i ngrohjes ishte joeficient, duke kontribuar në humbje të mëdha termike. Kjo, përveç që dëmtonte qytetarët në aspektin socio-ekonomik, është në kundërshtim edhe me marrëveshjet ndërkombëtare. Kosova si nënshkruese e Traktatit të Energjisë (TE) si dhe aspiruese e integritimit në Bashkim Evropian (BE), është e obliguar të respektojë direktivat e BE-së, më saktësisht Direktivën 2004/8/EC për promovimin e sistemit të kogjenerimit si dhe Direktivën 2006/32/EC për arritjen e caqeve të eficiencës prej 9% deri në vitin 2016⁵.

Për këto arsye, në vitin 2010 BE ndihmoi Kosovën duke iniciuar edhe një studim të fizibilitetit për ndërtimin e sistemit të kogjenerimit, i cili përdor avullin e prodhuar nga termocentrali “Kosova B” dhe e shfrytëzon atë për nevojat e Termokos-it⁶. Ky projekt ka filluar së funksionuari në tetor të vitit 2014.

Në këtë studim, Instituti GAP ka analizuar ndikimin e kogjenerimit në konsumin e energjisë elektrike në Prishtinë. Për këtë qëllim, GAP ka zhvilluar 350 anketa me konsumatorë të “Termokos”, ku janë krahasuar dy sezonet e fundit dimërore: sezoni i para kogjenerimit (dhjetor 2013 - janar 2014), dhe sezoni me kogjenerim (dhjetor 2014 - janar 2015).⁷

2. Funksionimi i ngrohjeve qendrore

Në Kosovë ekzistojnë katër ndërmarrje të ngrohjes qendrore: në Prishtinë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Zveçan, të cilat kapacitetin total të instaluar e kanë 262 MW dhe mbulojnë afërsisht 5% të kërkesës⁸.

⁴ Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRë) - Raporti vjetor 2014. Fq. 72.

Burimi: <http://bit.ly/1CUGICA> (hapur së fundi më 22 korrik 2015)

⁵ “Energy End-Use Efficiency and Energy Services - Directive 2006/32/EC of the European Parliament.” Burimi: <http://bit.ly/1efWFaZ> (hapur së fundi më 17 korrik 2015)

⁶ COWI & IPF Consortium, “Studimi i Fizibilitetit Të Kogjenerimit 2010-2011.”

⁷ Shpërndarja e kësaj mostre është bërë në Dardani, Ulpianë, Kodër të Diellit dhe në ndërtesat e Qendrës së Prishtinës, lagje këto ku Termokos operon. Studimi mbështetet edhe në burime sekondare, në analizat e ekspertëve të fushës së energjisë si dhe udhëheqës të projektit të kogjenerimit, intervista me akterët relevant dhe të dhënat e konsumit të energjisë të siguruar nga KEDS.

⁸ Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Raporti Vjetor 2014. Fq. 69.

Ndërtimi i këtyre ndërmarrjeve është bërë kryesisht gjatë viteve të 1970-1980.


Mirëpo, niveli i ulët i investimit në to ka rënduar dukshëm gjendjen financiare të tyre. Me kalimin e kohës këto vështirësi financiare janë thelluar edhe më shumë si rezultat i varësisë së këtyre ndërmarrjeve në importin e mazutit, niveleve gjithnjë e më të larta të humbjeve të ujit gjatë furnizimit me ngrohje, si dhe nivelit të ulët të inkasimit. Këto probleme kanë përcjellë vazhdimisht sistemin e ngrohjeve qendrore në Kosovë dhe kanë pamundësuar këto ndërmarrje të ofrojnë ngrohje cilësore për qytetarët.

Shfrytëzimi i energjisë elektrike për ngrohje, ka efikasitet shumë të dobët dhe gjatë dimrit ngarkon sistemin energjetik të Kosovës duke shkaktuar ndërprerje të mëdha dhe import të energjisë elektrike. Në këto rrethana, funksionalizimi i ngrohjeve qendrore ka një rëndësi qenësore në arritjen e caqeve të efijencës. Po ashtu, marrë parasysh nivelin e ulët të prodhimit të energjisë elektrike si dhe ngritjes së vazhdueshme të kërkesës, përdorimi i sistemit të ngrohjeve qendrore është mundësia më e mirë për t'i përmbushur këto kërkesa dhe për t'i arritur objektivat e BE-së në reduktimin e ndotjes së ambientit dhe rritjen e efijencës.

Një hap i rëndësishëm drejt zhvillimit dhe modernizimit të ngrohjeve qendrore është marr në vitin 2014 në Prishtinë, me ndërtimin e sistemit të kogjenerimit.

Siç mund të shihet në Figurën 1, para ndërtimit të këtij sistemi, në termocentralet e zakonshme mesatarisht 60-70% e energjisë termike humbet, ndërsa me ndërtimin e sistemit të kogjenerimit vetëm 10% e energjisë humbet kurse pjesa tjetër mund të shfrytëzohet për ngrohje.

Figura 1: Humbjet e energjisë në Termocentrale



Burimi: <http://bit.ly/1CPsB1P>⁹

Për ndërtimin e sistemit të kogjenerimit janë ndarë gjithsej 37 milion e 325 mijë euro¹⁰. Këto mjete janë dhënë nga Komisioni Evropian (13.8 milionë euro), Komuna e Prishtinës (3.8 milionë euro), Banka Gjermane për Zhvillim - KfW (15 milionë euro), Qeveria e Kosovës (1.2 milion euro), ajo e Suedisë (2 milionë euro), dhe ajo e Luksemburgut (1.5 milion euro). Nga ky financim, 32 milionë e 325 mijë euro janë grante, kurse 5 milionë euro janë kredi nga KfW.

Këto fonde janë shfrytëzuar për modernizimin e tubacioneve të vjetruara, ndërtimin e dy pompave në termocentralin “Kosova B” dhe një afër termocentralit “Kosova A” dhe planifikimin për rehabilitimin e 50 nën-stacioneve. Këto përmirësime, përveç që kanë reduktuar përqindjen e humbjeve gjatë ngrohjes, ato kanë rritur edhe efikasitetin e ngrohtores, duke e rritur temperaturën e ujit që qarkullon në tubacione prej 70 °C në 120 °C gjatë kohës së pikut¹¹.

⁹ Combined heat and power – Cogeneration. Burimi: <http://bit.ly/1CPsB1P> (hapur së fundi më 22 korrik 2015).

¹⁰ Raport intern i “Termokos” për Projektin e Kogjenerimit.

¹¹ Raporti tremujor i Progresit nr.12 – Ngrohësia dhe Qytetit Sh. A. TERMOKOS – KfW – Fq. 2. Burimi: <http://bit.ly/1CUGICA> (hapur së fundi më 22 korrik 2015).

Në vijim kemi paraqitur të gjeturat tona rreth ndikimit të kogjenerimit në konsumin e energjisë elektrike dhe bazuar në këto të dhëna, kemi ofruar disa skenarë të kursimit të energjisë elektrike përmes zëvendësimit të ngrohjes elektrike me atë të ngrohjes qendrore.

3. Efektet e kogjenerimit tek konsumatorët e Termokos-it

Termokos-i ka një rrjet prej 11,281 konsumatorëve. Instituti GAP ka zhvilluar një anketë me 350 konsumatorë. Bazuar në të dhënat e mbledhura, kemi ofruar një varg konstatimesh rreth konsumit të energjisë elektrike, burimeve të ngrohjes, shpenzimeve për ngrohje, kënaqshmërinë e qytetarëve me shërbimet e ngrohjes, e të tjera.

Paraqitja e gjetjeve ndjek strukturën e pyetësorit dhe krahason sezonin dimëror pa kogjenerim, pra dhjetor 2013 - janar 2014, me sezonin dimëror dhjetor 2014 - janar 2015 kur kogjenerimi ka hyrë në funksion. Të dhënat e grumbulluara përmes anketës, janë krahasuar me të dhënat e siguruar nga KEDS, për konsumin e energjisë në këto dy periudha kohore të krahasueshme.


3.1 Konsumi i energjisë elektrike

Në sezonin dimëror 2013-2014, konsumatorët e anketuar përdornin kryesisht ngrohje elektrike. Si rezultat, në dhjetor 2013, një familje ka paguar mesatarisht 77 euro për faturë të energjisë elektrike, ndërsa në janar 2014 ka paguar faturë prej mesatarisht 82 euro. Pas funksionimit të kogjenerimit, pagesa mesatare në dhjetor 2014 ka qenë 52 euro, ndërsa në janar 2015 mesatarisht 54 euro për faturë. Këto të dhëna tregojnë se pas përmirësimit të ngrohjes qendrore, faturat e energjisë elektrike kanë rënë mesatarisht për 34%. Figura 2 paraqet ndryshimin e konsumit të 313 respondentëve të cilët na kanë treguar faturat për dy sezonet dimërore.

Në sezonin e parë (2013-2014) të anketuarit kanë paguar mesatarisht 24,877 euro ndërsa në sezonin e dytë (2014-2015) të njëjtit kanë paguar në total afërsisht 16,514 euro apo 34% me pak,¹² duke i mbajtur faktorët tjerë të izoluar si numri i anëtarëve të familjes dhe të hyrat financiare.

¹² Kalkulimi i kursimit të energjisë elektrike është bërë duke larguar efektin e ngritjes së dyfishtë të çmimit të energjisë elektrike gjatë vitit 2014.

Figura 2: Ndryshimi i faturave të energjisë elektrike tek konsumatorët e anketuar




Nga figura e mësipërme shohim se për dy muaj, shuma totale e kursyer është mesatarisht 16,727 euro. Nëse kjo shifër aplikohet te të gjithë konsumatorët e Termokos-it, atëherë del që mesatarisht 602,867 euro janë kursyer për vetëm dy muaj, ndërsa përkthyer në kilovat për orë janë kursyer rreth 6,512,559 kWh¹³.

Ndonëse sasia e kursyer është e kënaqshme, cilësia e ngrohjes nuk ka qenë e njejtë në secilën lagje. Në disa lagje, ngrohja qendrore ka funksionuar më mirë, ndërsa në disa tjera më dobët. Në aneksin nr. 1 mund të shihen ndryshimet e konsumit të energjisë elektrike në bazë të lagjeve.

3.2 Burimi kryesor i ngrohjes

Në sezonin dimëror 2013-2014, mesatarisht 83% e të anketuarve e kanë përdorur energjinë elektrike si burim primar të ngrohjes dhe vetëm 4% e kanë përdorur ngrohjen qendrore. Ndërsa pas funksionimit të kogjenerimit, burimi primar i ngrohjes me energji elektrike ka qenë 5%, kurse me ngrohje qendrore 92%.


¹³ Për kalkulimin e energjisë elektrike të kursyer në kWh nga faturat e energjisë elektrike është hequr TVSh-ja.

Figura 3: Burimi primar i ngrohjes para dhe pas kogjenerimit

Kalimi nga ngrohja elektrike në ngrohje qendrore, përveç që ka reduktuar shpenzimet, ka siguruar edhe stabilitet dhe siguri të ngrohjes, ngase varësia e ngrohjes me energji elektrike krijon pasiguri në raste kur Kosova përballet me mungesa të energjisë elektrike. Po ashtu, kjo energji e kursyer gjatë kohës së dimrit zvogëlon nevojën e Kosovës të importojë energji elektrike të shtrenjtë nga vendet e rajonit.

3.3 Hapësira banuese që ngrohet

Në sezonin dimëror 2013-2014, mesatarisht 34% e konsumatorëve të Termokos-it kanë ngrohur 100% të hapësirës banuese, ndërsa 26% e tyre kanë ngrohur vetëm gjysmën. Kjo përqindje e vogël e hapësirës së ngrohur ka ardhur si pasojë e mosfunksionimit të Termokos-it si dhe kostos së lartë të energjisë elektrike për t'i ngrohur të gjitha dhomat. Ndërsa pas funksionimit të kogjenerimit, 91% e konsumatorëve kanë ngrohur tërë hapësirën banuese. Vetëm 2% e konsumatorëve kanë ngrohur gjysmën e hapësirës banuese. Figura 4 paraqet përqindjet e ndryshimit të hapësirës banuese të ngrohur brenda dy sezoneve dimërore.

Figura 4: Përqindja e hapësirës së ngrohur para dhe pas kogjenerimit

Ky kalim nga ngrohja e më pak se 30% e hapësirës së banimit në 100%, përveç që ka ardhur me një kosto më të vogël, ka ngritur edhe cilësinë e jetesës së banorëve që janë të lidhur me këtë ngrohje qendrore.

3.4 Izolimi i objekteve banuese mbas sezonit dimëror (2013-2014)

Faktori tjetër që mund të ndikojë në ndryshimin e konsumit të energjisë elektrike është izolimi i objekteve banuese. Pra nëse objektet izoloohen, pritet që konsumi i energjisë elektrike për ngrohje të jetë më i vogël. Në këtë rast, izolimi pas sezonit 2013-2014 mund të ketë ndikuar që edhe konsumi i energjisë elektrike për ngrohje të jetë më i vogël. Mirëpo, të dhënat tregojnë se një izolim i tillë ka ndodhur në masë shumë të vogël dhe ndikimi në konsumin e energjisë elektrike mund të mos jetë thelbësor. Figura 5 tregon se vetëm 11% e të anketuarve kanë marrë disa masa të izolimit, ndërsa 89% e tyre nuk kanë bërë asnjë ndryshim në izolim.

Figura 5: Izolimi i objekteve banuese



3.5 Qëndrimi i respondentëve për cilësinë e ngrohjes

Përmirësimi i sistemit të ngrohjes ka ndikuar edhe në qëndrimin e konsumatorëve karshi Termokos-it. Në sezonin e parë, Tabela 1 tregon se 94% e konsumatorëve kanë qenë të pakënaqur me cilësinë e ngrohjes, ndërsa në sezonin e dytë vetëm 8%. Ky përmirësim i perceptimit ka ndikuar dukshëm edhe në rritjen e arkëtimit të faturave dhe përmirësimin e gjendjes financiare të kësaj kompanie.

Tabela 1: Qëndrimi i konsumatorëve ndaj Termokos-it para dhe pas kogjenerimit


	Sezoni dimëror 2013-2014			Sezoni dimëror 2014-2015		
	Cilësia e Ngrohjes	Çmimi i ngrohjes	Cilësia e shërbimit	Cilësia e ngrohjes	Çmimi i ngrohjes	Cilësia e shërbimit
Të pakënaqur	94%	88%	53%	8%	35%	17%
Neutral	5%	9%	34%	7%	22%	42%
Të kënaqur	1%	3%	13%	86%	44%	40%

3.6 Të ardhurat e ekonomive familjare dhe varfëria e energjisë

Një nga të gjeturat më shqetësuese të këtij hulumtimi është numri i madh i banorëve që jetojnë në varfëri të energjisë. Varfëria e energjisë konsiderohet kur shpenzimet në faturat të energjisë janë mbi 10% e të ardhurave familjare¹⁴.

Të dhënat tona sugjerojnë që para funksionimit të kogjenerimit, mesatarisht 88% e ekonomive familjare jetonin në varfëri të energjisë. Pas përmirësimit të ngrohjes qendrore, shpenzimet për energji elektrike kanë rënë dhe si pasojë edhe varfëria e energjisë ka rënë në 83%.

Figura 6: Pagesa e faturave të energjisë si përqindje e të ardhurave mujore gjatë sezonit të dimrit¹⁵



Përkundër faktit që një numër i konsiderueshëm i personave ka arritur të dal jashtë varfërisë së energjisë, prapëseprapë numri i të mbeturve është alarmant. Çmimi i energjisë për ngrohje është mjaft i lartë kur marrim parasysh që shpenzimet operative të Termokos-it kanë rënë, dhe arkëtimi është rritur për mbi 176% në krahasim me vitin e kaluar. Kjo nënkupton se çmimi i ngrohjes për metër katror (m^2), i cili është i njëjtë me vitin e kaluar, është shumë i lartë dhe se duhet të ri-kalkulohet bazuar në kostot e prodhimit që realisht janë shumë më të vogla.

¹⁴ ECOSOC - Overcoming the Energy Poverty in Underdeveloped Countries 2014. Fq. 4. Burimi: <http://bit.ly/1CPHTUc> (hapur së fundi më 16 korrik 2015)

¹⁵ Në definicionin e varfërisë së energjisë përfshihen pagesat e energjisë elektrike dhe termike të një familjes.

4. Disa skenarë për zgjerimin e rrjetit të Termokos-it

Bazuar në të dhënat e paraqitura më lartë, del se zvogëlimi i konsumit të energjisë elektrike për 34% kryesisht i atribuohet përmirësimit të ngrohjes qendrore përmes përdorimit të kogjenerimit. Krahë kursimit, kogjenerimi ka ngritur edhe cilësinë e jetesës duke ua mundësuar konsumatorëve që t'i ngrohin të gjitha dhomat.

Duke u ofruar qytetarëve ngrohje më cilësore, Termokos-i ka arritur që të ngrit inkasimin për 176% dhe të ulë kostot operative për mbi 10 milion euro¹⁶. Këto përmirësime ndikojnë direkt në mirëqenien e qytetarëve që janë të lidhur me këtë kompani, mirëpo numri i tyre është vetëm 12,000, ndërsa parashikimet e rritjes së objekteve banuese në Prishtinë është afërsisht 200,000 deri në vitin 2020¹⁷.

Duke u bazuar në të gjeturat e këtij studimi si dhe potencialet e kursimit përmes zgjerimit të rrjetit të Termokos-it, Instituti GAP ofron në vijim disa skenare për mundësitë e kursimit të energjisë elektrike si dhe vlerës së saj monetare.


Tabela 2 paraqet ndikimin e zgjerimit të Termokos-it në disa skenarë. Në skenarin e parë, ku numri i banorëve është i pandryshueshëm, kursimi i energjisë elektrike për një sezon dimëror është 16,281,396 kWh. Dyfishimi i konsumatorëve do ta ngriste këtë kursim në 32,562,793 kWh, ndërsa trefishimi i konsumatorëve do të kursente mbi 48,844,189 kWh.

Tabela 2: Parashikimet e kursimit të energjisë elektrike sipas skenarëve të zgjerimit të rrjetit të Termokos-it

Zgjerimi i rrjetit	Numri i konsumatorëve	Kursimi i faturave për një sezon dimëror	Kursim në kWh për një sezon dimëror	Kursim në MWh për një sezon dimëror
0%	11,281	€ 1,507,167	16,281,396	16,281
100%	22,562	€ 3,014,334	32,562,793	32,563
200%	33,843	€ 4,521,501	48,844,189	48,844
300%	45,124	€ 6,028,668	65,125,585	65,126
400%	56,405	€ 7,535,835	81,406,982	81,407

¹⁶ Biseda me zyrtarë të NQ Termokos

¹⁷ IBE – Kosovo Combined Heat and Power (CHP) feasibility study 2005. Fq. 9. Burimi: <http://bit.ly/1liBYHE> (hapur së fundi më 13 korrik 2015)



Bazuar në këtë studim, në lagjet ku operon Termokos-i, për dy muaj janë kursyer mesatarisht 602,867 euro apo 6,512,559 kWh¹⁸. Nëse kjo aplikohet për 5 muaj ose një sezonë dimëror (15 tetor - 15 prill), del se janë kursyer mesatarisht 1,507,167 euro apo 16,281,396 kWh. Në skenarët e mësipërm është aplikuar ky trend i kursimit proporcionalisht me rritjen e zgjerimit të rrjetit të konsumatorëve.

Zëvendësimi i ngrohjeve elektrike me ngrohje qendrore në Prishtinë, do të kursente mbi 7.5 milion euro në vit nga energjia elektrike, ndërsa i gjithë projekti i kogjenerimit ka kushtuar afërsisht 37 milionë euro. Për më pak se pesë vite, kursimi nga ngrohja qendrore do të paguante këtë investim dhe në të njëjtën kohë do të kishim një ngrohje më cilësore dhe më të qëndrueshme në Prishtinë.

Përparësitë e kursimit nga ngrohja qendrore nuk janë të limituara vetëm me ngrohje. Në shumicën e vendeve të rajonit dhe të Evropës, ndërmarrjet e ngrohjeve qendrore furnizojnë objektet banuese edhe me ujë të ngrohtë për larje si dhe klimatizim gjatë verës, dy shërbime këto që shpenzojnë sasi të madha të energjisë elektrike. Kursimet nga funksionimi i këtyre mundësive hapin rrugë edhe për më shumë kursime monetare dhe më pak nevojë për gjenerim të energjisë elektrike.

¹⁸ Çmimi për kWh (0.11/kWh) është marrë nga të dhënat e KEDS si mesatare gjatë kohës së dimrit për konsumatorët në lagjet e qendrës së Prishtinës.

5. Përfundime dhe rekomandime

Në bazë të të gjeturave të kësaj analize, Instituti GAP vlerëson se investimi prej 37 milionë euro në ndërtimin e sistemit të kogjenerimit ka zvogëluar konsumin e energjisë elektrike për mesatarisht 34% në zonat e Prishtinës që janë të lidhura me Termokos-in. Vlera monetare e këtij kursimi është afërsisht 602,867 euro për vetëm dy muaj (dhjetor 2014-janar 2015), ndërsa kërkesa për energji elektrike është zvogëluar për afërsisht 6,512,559 kWh.

Krahas kursimit të energjisë elektrike, ky sistem ka ulur dukshëm edhe pakënaqësinë e qytetarëve që kishin më herët ndaj Termokos-it, dhe në të njëjtën kohë ka dyfishuar nivelin e arkëtimit.

Marrë parasysh përfitimet e funksionimit të Termokos-it si dhe mundësitë e përmirësimit edhe të ngrohtoreve tjera në Kosovës, Instituti GAP rekomandon:

Për Termokos-in:

- Të bëhen përmirësime në rrjetin e shpërndarjes të lagjet e qendrës së Prishtinës (Aktash, Rr. Anton Qeta, dhe Rr. UCK) dhe Kodrës së Diellit, që sipas anketës dhe të dhënave për lagje të paraqitura në aneksin nr. 1, janë lagjet të cilat kanë pasur kursimin më të vogël të energjisë elektrike si pasojë e funksionimit më të dobët të ngrohjes qendrore;
- Të zëvendësohen tarifat normative me tarifa matëse dhe të bëhet instalimi i matësve të konsumit të energjisë termike siç obligohet me nenin 32 të Ligjit për Ngrohje Qendrore;
- Gjatë sezonit të ngrohjes, në orët e natës të mbahet temperatura e dhomës prej max. 20°C, e jo të funksionojë njëjtë me temperaturat e ditës. Kjo do të përmirësonte komfortin e konsumatorëve dhe do të kursente energji termike;
- Të bëhet një studim nga vet Termokos-i për numrin e konsumatorëve që dëshirojnë të lidhen me këtë ngrohtore, dhe rrjedhimisht të përpilohet një plan afatmesëm për kërkimin e granteve apo kredive shtesë për lidhjen e më shumë konsumatorëve.

Për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë:

- Të ri-kalkulohen tarifat e konsumatorëve të Termokos-it, ngase që nga viti i kaluar (2013-2014) shpenzimet operative kanë rënë mbi 10 milion euro, në të njëjtën kohë arkëtimi është rritur për 176%;

- Të insistojë që ngrohtoret qendrore që në sezonin dimëror 2015-2016 të instalojnë metrat matës të konsumit të energjisë termike siç obligohen me ligj;
- Të dizajnojë tarifa nxitëse për promovimin e ndërtimit të ngrohtoreve të reja në Kosovë;


Për komunitet:

- Komunitet me dendësi të lartë të popullsisë të bëjnë një studim të kërkesës në treg për ngrohje qendrore dhe të shikojnë nëse ndërtimi i ngrohjes qendrore është i mundshëm;
- Komunitet e Gjakovës përmes një kredie afatgjate t'i ndihmojë financiarisht NQ "Gjakova" në rehabilitimin edhe modernizimin e ngrohtores ose të shqyrtojë mundësinë e privatizimit të kësaj ndërmarrjeje.
- Të shikohet mundësia e ndërtimit të ngrohtores së re në Drenas, e cila do të lidhej me "Feronikelin".

Për Qeverinë:

- Qeveria bashkë me ZRrE-në të krijojnë kushte më të favorshme përmes incentivave fiskale dhe tarifore në mënyrë që të rriten investimet private në ngrohtore qendrore;
- Të përpilohet një plan strategjik institucional për identifikimin e energjisë termike të pashfrytëzuar, si dhe përcaktimin e caceve të prodhimit përmes burimeve të ripërtëritshme.

Shtojca 1: Ndryshimi i faturave të energjisë elektrike sipas lagjeve të Prishinës





Instituti GAP është Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Instituti GAP mbështetet nga:



Kjo analizë është publikuar në kuadër të Konsorciumit Kosovar të Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm:

